

## **Paketa Fiskale 2019**

### **Pyetje të shpeshta**

- 1. A mund të regjistrohet më shumë se një herë një person fizik me të njëjtin numër identifikimi personal?**

Personi fizik që aktualisht është i regjistruar me një NIPT/NUIS, nuk mund të regjistrohet me një NIPT/NUIS të ri. Në rast se kërkon të pajset me një NIPT/NUIS të ri, fillimisht ai duhet të çregjistrojë NIPT-in/NUIS-in ekzistues.
- 2. Në rast se personi fizik do të ushtrojë një veprimtari të re në vende të ndryshme nga adresa kryesore, si duhet të veprojë?**

Kur tatimpaguesi do të ushtrojë një veprimtari të re, ai pajset me një certifikatë me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.
- 3. Kur mund të kalojë një tatimpagues në regjistrin pasiv?**

Një tatimpagues kalon në regjistrin pasiv, kur deklaron në QKB pezullim të veprimtarisë tregtare dhe paguan detyrimet tatimore.
- 4. Si vepron Administrata Tatimore në rastet kur konstaton se tatimpaguesi kryen transaksione ndërkohë që është në statusin pasiv?**

Transaksionet e kryera nga tatimpaguesi që rezultojnë në regjistrin pasiv, konsiderohen shkelje administrative. Për shitësin, i cili është në regjistrin pasiv Administrata Tatimore bën vlerësim tatimor, ndërsa për blerësin bëhet vlerësim tatimor për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.
- 5. Çfarë lehtësimi përfiton tatimpaguesi nëse pranon vlerësimin tatimor në rastin e kundërvajtjeve në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve?**

Për të tilla kundërvajtje, nëse tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, gjoba zbritet me 30% të vlerës.
- 6. Sa është shkalla tatimore e TVSH-së për furnizimin e shërbimit të reklamës në mediat audiovizive? A zbatohet kjo shkallë dhe për shërbimet e tjera?**

Shkalla tatimore e TVSH-së së aplikuar për furnizimin e shërbimit të reklamës në mediat audiovizive është 6%. Kjo shkallë tatimore zbatohet vetëm për këtë lloj shërbimi nga media audiovizive.
- 7. Sa është shkalla tatimore e TVSH-së për shitjet librat e çdo lloji?**

Shkalla tatimore e TVSH-së së aplikuar për furnizimin e librave të çdo lloji është 6%.
- 8. Sa është norma e kompensimit të fermerëve?**

Norma e kompensimit për fermerët është 6%.
- 9. Cilat janë përjashtimet për TVSH-në që ka parashikuar Paketa e re Fiskale?**

Në Paketën Fiskale janë përjashtuar nga TVSH-ja:  
furnizimi i makinave bujqësore,

furnizimi i inuteve bujqësore,

furnizimi i shërbimeve veterinarë (me përjashtim të atyre për kafshët shtëpiake), importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave.

**10. Cilat janë normat tatimore të Tatimit mbi të Ardhurat nga punësimi sipas nivelit të pagës bruto?**

Normat tatimore të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi janë:

0% - Paga mujore bruto deri 30,000 lekë;

13% - Pjesa e pagës mujore bruto mbi 30,000 - 150,000 lekë

23% - Pjesa e pagës mujore bruto mbi 150,000 lekë

**11. Cilat konsiderohen të ardhura me burim në Shqipëri sipas Paketës së re Fiskale?**

Të ardhura me burim në Shqipëri konsiderohen edhe të ardhurat e realizuara nga jorezidentë, të përfituara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person rezident në Shqipëri.

**12. A i nënshtrohet Tatimit mbi Fitimin personat jorezident?**

Tatimit mbi Fitimin i nënshtrohet edhe çdo person jorezident që nuk është i regjistruar për shkak të përcaktimit të deritashëm të ligjit në Shqipëri, si dhe i cili nuk i nënshtrohet Tatimit mbi të Ardhurat.

**13. A njihen si shpenzim dietat?**

Konsiderohen të panjohura shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore.

**14. Cila është shkalla tatimore që aplikohet mbi dividendin dhe kushtet e pagesës së tatimit mbi dividendin?**

Për periudhat tatimore 2017 dhe më parë si dhe për atë të vitit 2018, tatimi aplikohet 8%, me kusht që:

- tatimi që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019;
  - tatimi për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019.
- Mosplohtësimi i kushtit sipas afatit më lart, bën që tatimi mbi dividendin të zbatohet në shkallën 15%. Nga viti 2019 e më pas pavarësisht datës së deklaramit/pagesës së tatimit, shkalla tatimore mbetet 8%.

**15. Deri në çfarë shume të detyrimit tatimor vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero?**

Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepicës së kredisë, me vlerë deri në 1,000 (një mijë) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero. Për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga Administrata Tatimore.

**16. Si realizohet shlyerja e detyrimeve tatimore në momentin e pagesës nëse ka detyrime të prapambetura?**

Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj detyrimi, në qoftë se këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.

## Për procedurat tatimore

1. **A mund të mbajë personi fizik i vetëpunësuar në ambientet e aktivitetit, persona të papaguar të familjes, të padeklaruar?**

Personi fizik i vetëpunësuar mund të mbajë në ambientet e aktivitetit, persona mbi 16 vjeç, të padeklaruar, të cilët kategorizohen si persona të papaguar të familjes. Fakt i cili vërtetohet nga certifikata familjare. Në rast se nga verifikimi në terren konstatohet në vendin e aktivitetit një person i papaguar i familjes ose që bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin dhe nuk disponohet momentalisht certifikata familjare atij (tatimpaguesit) i lihet 5 ditë kohë për të provuar këtë fakt.

2. **Tatimpagues biznes i vogël, i cili gjatë vitit fiskal ka ushtruar aktivitet vetëm për disa ditë në periudha të shkëputura dhe jo vazhdimisht, a ka detyrim të dorëzojë deklaratën e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin?**

Pavarësisht faktit nëse ky tatimpagues gjatë vitit paraardhës ka ushtruar aktivitet ekonomik për periudha të shkurtra kohore, apo vetëm në disa muaj, ka detyrimin të dorëzojë deklaratën vjetore të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin.

3. **Çfarë dokumentesh duhet të mbajë apo të afishojë në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit një tatimpagues i regjistruar rishtazi?**

Një tatimpagues i regjistruar rishtazi duhet që në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit, të afishojë në një vend të dukshëm:

- listën e çmimeve për mallrat/shërbimet e ofruara,
- kopje të certifikatës së regjistrimit,
- certifikatë licencimi nëse ka,
- njoftim për të drejtën e pajisjes së klientit me kuponin tatimor.

Gjithashtu, tatimpaguesi duhet të mbajë në gjendje pune pajisjen fiskale.

4. **Si dhe ku mund të verifikojë një tatimpagues nëse tatimpaguesi tjetër me të cilin do të kryejë një transaksion, është apo jo në statusin aktiv?**

Çdo tatimpagues përpara se të hyjë në një transaksion me një tatimpagues tjetër ka mundësinë të verifikojë statusin e tij dhe të sigurohet që blerësi apo shitësi është tatimpagues me status “Aktiv” dhe mund të kryejë transaksione.

Për të verifikuar statusin e një tatimpaguesi (Aktiv/Pasiv etj) në faqen zyrtare të administratës tatimore, [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), publikohet lista e tatimpaguesve që kanë kaluar në regjistrin pasiv, e cila përditësohet çdo ditë pune. Gjithashtu, tatimpaguesi mund të konsultohet me regjistrin tregtar në faqen zyrtare të QKB-së, [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).

## Qendra e Thirrjeve

1. **Për një subjekt është aktivizuar Tatimi mbi të Ardhurat Personale. Ndërsa te përgjegjësia tatimore del e aktivizuar, te deklarata E-sig 025 është jo aktive kutiza e TAP. Cila është procedura që duhet të ndjekim?**

Ju duhet t'i drejtoheni Zyrës së Shërbimit të Tatimpaguesve pranë Drejtorisë suaj Rajonale Tatimore për të marrë ndihmën dhe asistencën e nevojshme. Është e nevojshme që në të dhënat tuaja të ndryshoni kategorizimin për sigurimet shoqërore, pra duhet të jeni punëdhënës ose i vetëpunësuar me punëmarrës.

2. **Në një adresë kam qenë i regjistruar si qiramarrës dhe kam deklaruar prej janarit 2018 mbylljen e NIPT-it sekondar, por në faqen elektronike vazhdon më shfaqet, si mund të më ndihmoni ?**

Ju duhet të bëni përditësimin e të dhënave ne QKB, ky ndryshim transmetohet edhe ne Sistemin Tatimor ne dosjen tuaj elektronike. Për më shumë informacion mund t'i drejtoheni Zyrës së Shërbimit të Tatimpaguesve.

3. **Kam nevojë të pajsem me një vërtetim që nuk kam detyrime tatimore, por në sistem më shfaqen disa kamatë vonesa që i kam paguar me kohë. Kam bërë disa herë kërkesë për kërkesë për kompesimin, por ende i i kam marrë? Si mund të veprojmë?**

Kompetenca ligjore e sistemeve është e Drejtorisë Rajonale Tatimore. Në rast mosveprimi nga ana e administratës tatimore, legjislacioni ju jep të drejtën e ankimit për mosveprim nga ana e punonjësve. Kodi i Procedurës Administrative parashikon kthimin e një përgjigjeje brenda 7 ditëve.

4. **Kam hapur një NIPT të ri për të ushtruar një aktivitet. Kërkoj të di ku ndodhen zyrat e Shërbimit të Tatimpaguesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore?**

Adresa është : Përballë shkollës "Sabaudin Gabrani", tek "21 Dhjetori" Rr. "Nikolla Lena", Tel: ++35542425901/902. Pranë zyrave ju mund të merrni gjithë asistencën e nevojshme pa pagese.

5. **Biznesi i vogël ka kaluar me TVSH në datë 01.04.2018, si do t'i dokumentojë blerjet e investimeve ( tavolina , karrike, frigoriferë etj.)**

Edhe për aktivet afatëgjata të blera, fatura do të regjistrohet në Librin e Blerjeve njësoj si për blerjet e tjera të mallrave.

6. **Një kompani e hapur në Shqipëri si degë e një shoqërie të huaj, objekt aktiviteti ka ofrimin e shërbimeve IT. Shoqëria shqiptare i ka prerë një faturë me vlerë 3,500 euro kompanisë mëmë në Itali për shërbim konsulence. A është e përjashtuar nga TVSH-ja**

**kjo faturë duke qenë se është eksport apo nëse kalon vlerën 2,000,000 lekë për faturat e prera për Italinë kalon si subjekt me TVSH?**

Ju duhet t'i referoheni nenit 24 të ligjit të TVSH-së. Për shitje pa TVSH, transaksioni është qarkullim i tatueshëm me shkallë tatimore 0%. Nëse kryeni eksporte deri në 2 milionë lekë, ju nuk jeni të detyruar të regjistroheni në TVSH. Ku ju e kaloni këtë shumë, ligji ju detyron të regjistroheni në TVSH.

**7. Automjetet që blihen nga administratori i biznesit a njihet si shpenzim për biznesin?**

Legjislacioni tatimor njih si blerje, të gjitha aktivet që janë në emër të shoqërisë. Çdo blerje që lidhet me individin nuk njihen si aktive.

**8. Kam shkarkuar aplikacionin M-Tax në telefon dhe kam harruar passëordin. Si mund të veproj për t'u pajisur me passëord të ri?**

Ju duhet të drejtoheni pranë Zyrës së Shërbimit të Tatimpaguesve për të marrë ndihmën e nevojshme.

**9. Kërkoj informacion në lidhje me interesin e peregjistruar që më shfaqet tek detyrimet në kohë reale. Çfarë detyrimi është?**

Interesat llogariten nga sistemi dhe kanë të bëjnë me mospagimin në kohë të detyrimeve tatimore, dhe llogaritja e tij nuk nderpritet nese ju nuk paguani detyrimet e shfaqura. Nese ju do te vendosni te paguani, interesat e peregjistruara nderpritin ditën e pageses. Interesat e llogaritura janë penaltete dhe regjistrohen në kontabilitet në llogarinë “Gjoha”.

**10. Jam një biznes i vogël, person fizik. Bëra deklarinë vjetor të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, xhiroja vjetore ishte 4,800,000 lekë. Sistemi me nxori detyrimin për të paguar Tatim mbi Fitimin. A duhet të bëj ndonjë kërkesë të veçantë për t'u hequr nga sistemi apo korrigjohet nga inspektori përkatës?**

Problemi që ngrihet ka të bëjë me datën e regjistrimit në mes të periudhës (vitit) dhe xhiron e realizuar në fakt për vitin kalendarik. Bazuar të këto rregulla bëhet dhe konvertimi i xhiros vjetore për vitin pasardhës, duke ndryshuar sipas rastit edhe përgjegjësinë tatimore. Legjislacioni tatimor për rastin konkret nuk parashikon pagesë të TFTH për xhiro të realizuar 4 milionë lekë. Ju duhet të drejtoheni pranë Zyrës së Shërbimit të DRT-së që ju administron për ndihmë dhe asistencë.

**11. Kërkoj të deklaroj dhe të shkarkoj online kontratën e qirasë! Si mund ta bëj?**

Në faqen zyrtare të DPT-së [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), klikoni në rubrikën “Individ” tek “Deklarimi dhe pagesa”. Aty gjeni të gjithë procedurën e deklaramit dhe në dokumentet ndihmëse (Deklarimi i të ardhurave nga burime të tjera) keni formatin tip që kërkohet. Drejtoheni në

Zyrën e Shërbimit të Tatimpaguesve pranë DRT-së, për kryerjen e regjistrimit dhe do të asistoheni pa pagesë.

- 12. Sapo jam regjistruar dhe kërkoj të aksesohem/bëhem aktiv për herë të parë në sistem. Në rubrikën e-Sherbime, përveç NIPT-it kërkohet edhe Fjalëkalimi, si duhet të veprojë?**

Fjalëkalimi fillestar është Tatimetemia12. Kujdes, pandërprerje fjalëkalimin. Më pas ju duhet ta ndryshoni.

- 13. Jetoj në Itali dhe do të qëndroj edhe 2 muaj. Kam pasur një NIPT aktiv, a mund ta bllokoj nga këtu ku ndodhem ose ta pezulloj për 3 muaj pasi nuk më nevojitet?**

Legjislacioni tatimor, ju lejon pezullimin vetëm pasi të keni paguar të gjitha detyrimet tatimore. Pezullimin do ta kryeni prane QKB-se edhe nepermjet nje perfaqesuesin Tuaj ligjor.

- 14. Blloku i faturave ka 50 fatura me numër serial nga të cilat vjet kam përdorur 28 copë me numra 1-28. Për këtë vit, duhet të vazhdoj me numrin 29, apo duhet të filloj me numër të ri?**

Legjislacioni tatimor për mbajtjen e dokumenteve për qëllime tatimore i referohet ligjit të kontabilitetit. Viti ushtrimor dhe tatimor është i njëjtë 01.01.x.-31.12.x dhe i gjithë dokumentacioni fillon me numër rendor të ri për vitin ushtrimor. Dokumentacioni regjistrohet në mënyrë kronologjike dhe sistematike.

- 15. Jam person fizik, i vetëpunësuar. Doja të dija nga 1 janari 2019 sa është paga minimale për llogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore?**

Paga minimale në shkallë vendi prej 1 janarit 2019 është 26,000 lekë. Për deklarimin e periudhës vendosni në listëpagesë pagën bruto 26,000 lekë që t'ju gjenerohet deklarata.